

Konfidencialiteti

Të Dhënat Personale

Në mënyrë që të përftoni nga shërbimet software që ofrohen nëpërmjet platformës sonë, albaniasoftware.al kërkon që ju të regjistroheni duke përdorur e-mail in dhe fjalëkalimin tuaj. Të dhënat personale të cilat do të nevojiten me qëllim ofrimin e shërbimeve software, do të përpunohen vetëm pasi, në përputhje me Ligjin 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (“Ligji 9887/2008”), subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin e tij. Pëlqimi i subjektit për përpunimin e të dhënave personale mund të revokohet në çdo çast duke na kontaktuar në adresën elektronike info@albaniasoftware.al.

Gjithashtu, subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale nga kartela elektronike, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me Ligjin 9887/2008, duke na kontaktuar në adresën elektronike info@albaniasoftware.al. Në këtë rast albaniasoftware.al do të ndërmarrë menjëherë hapat e nevojshëm për bllokimin, fshirjen, ose kryerjen e korrigjimit sipas informacionit të saktë të dhënë nga vetë subjekti i të dhënave i identifikuar rregullisht.

Llogaria që ju hapni tek platforma e albaniasoftware.al është personale dhe si e tille e patransferueshme. Përdorimi i saj kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Albaniasoftware.al rezervon të drejtën për të fshirë llogarinë tuaj dhe për të pezulluar ofertat promovionale të përfituara deri në atë moment, në rast se konstaton se ju e perdorni atë jo në përputhje me sa më sipër.

Gjithashtu ne ju ofrojmë mundësinë të na kontaktoni apo të na dërgoni komente. Në rast se ju do të veproni në këtë mënyrë, atëherë, normalisht, adresa elektronike dhe të dhëna të tjera të dërguara do të ruhen në bazën e të dhënave.

Ne nuk do të transferojmë të dhënat tuaja personale te persona të tretë pa miratimin tuaj paraprak, me përjashtim të rasteve kur kjo kërkohet dhe lejohet nga legjislacioni në fuqi. Adresa elektronike dhe të dhënat e tjera personale të dërguara nëpërmjet platformës sonë do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dërguar, ose siç mund të përcaktohet në seksionin përkatës në platformën tonë.

Ndryshimi i Politikës së Konfidencialitetit

Albaniasoftware.al rezervon të drejtën të ndryshojë këtë Politike Konfidencialiteti në çdo kohë, duke publikuar versionin e ndryshuar.

Kushtet e përdorimit

Përgjegjësia

Informacioni i publikuar në këtë platformë përbën këshillë profesionale, dhe, nëse ju keni nevojë për një të tillë, ju lutemi t'i drejtoheni një prej zyrave tona. Ky material është hartuar nga albaniasoftware.al dhe ka për qëllim të japë një informacion të shkurtër përmbledhës për tematika në fushën software.

Lidhjet me faqe të tjera interneti, të përfshira në platformën tonë, nuk janë nën kontrollin e albaniasoftware.al, si rrjedhim ky i fundit nuk është përgjegjës për përmbajtjen e këtyre faqeve, apo ndryshimet në to. Qëllimi i botimit të këtyre lidhjeve është për lehtësi përdorimi apo informim të vizitorëve. Në asnjë rast, publikimi i këtyre lidhjeve me faqe të tjera nuk do të nënkuptojë se albaniasoftware.al është dakort me përmbajtjen e tyre apo përkrah organizatën apo shoqërinë me faqen e internetit të së cilës është bërë lidhja.

Albaniasoftware.al zbaton një politikë strikte të bazuar në standardet më të larta kontemporane për sa i përket përzgjedhjes së produkteve hardware të cilat përdor për ofrimin e shërbimeve software. Sqarojmë se pavarësisht sa më sipër albaniasoftware.al nuk mban asnjë përgjegjësi për cilësinë e shërbimeve hardware të ofruara nga kompanitë bashkëpunëtore si dhe për çdo dem direkt ose indirekt që mund t'i shkaktohet përfutjesve të shërbimit si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të kompanive të cilat ofrojnë produkte hardware.

E drejta e autorit

Përmbajtja e kësaj platforme mbrohet nga legjislacioni për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të. Albaniasoftware.al u lejon përdoruesve të kësaj platforme, të kopjojnë materialin në formë teksti e botuar në këtë platformë për qëllim përdorimi vetjak dhe jo për botime të mëtejshme. Përmbajtja e platformës mund të shtypet në letër dhe të shpërndahet me kusht që të bëhet i njohur burimi dhe të jetë e njejtë me origjinalin (kushtet e mësipërme nuk zbatohen për përmbajtjen e faqeve të tjera me të cilat është bërë lidhje në platformën tonë).